




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA TIRANE  
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E PUNEVE PUBLIKE

*RAPORTI TEKNIK*

***“NDERTIMI I KORSIVE TË DEDIKUARA PËR AUTOBUS NË DISA AKSE RRUGORE,  
ZGJIDHJA E NYJES KASTRIOTET DHE REHABILITIMI I STACIONEVE AUTOBUS NË  
ZONEN QËNDRORE TË TIRANËS.”***



*Projekt Zbatim*

A & E Engineering  
Ing. Entela Cano

*Tirane 2023*

## Kapitulli i parë

### Pershkrim i pergjthshem

Tipar i transportit aktual eshte fleksibiliteti, individualiteti dhe kryerja e tij nga subjekte shtetore dhe private, tipike per nje ekonomi tregu te hapur e konkruese, te cilat dalin ne dukje ne nje shkalle me te larte ne transportin rrugor, qe natyrshem ka prioritetin ne infrastrukturen e vendit.

### Vendi dhe relievi

Republika e Shqipërisë ndodhet në Europën Juglindore në brigjet perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Ajo shtrihet ndërmjet gjerësive veriore 39038’ dhe 42039’ dhe gjatësive lindore 19016’ e 21040’. Largësia më e madhe ndërmjet pikës më veriore dhe asaj më jugore është 335 km dhe ndërmjet pikës më lindore dhe asaj më perëndimore 150 km.

Shqipëria e ka sipërfaqen 28.748 kilometra katrorë dhe kufizohet: nga jugu, me Greqinë; nga lindja, me FYR e Maqedonisë; nga veriu dhe veriperëndimi, me Serbinë dhe Malin e Zi; nga veriu e verilindja, me Kosovën. Nga perëndimi laget prej detit Adriatik dhe nga jugperëndimi, prej atij Jon.

Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Shqipërisë është 1.094 km. Kufijtë tokësorë, detarë, liqenorë dhe lumore janë përkatësisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare është 427 km e gjatë: 273 km i përkasin bregdetit të Adriatikut dhe 154 km bregdetit të Jonit.

Tirana është kryeqendra e qarkut dhe rrethit me të njëtin emër dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Tirana ndodhet në qendër të Shqipërisë, rreth 35 km në lindje të Durrësit dhe rreth 40 km në veri-perëndim të Elbasanit, në një luginë e rrethuar nga Mali i Dajtit në lindje, kodrat e Kërrabës dhe Saukut në jug, kodrat e Vaqarrit dhe Yzberishtit në perëndim dhe ato të Kamzës në veri. Tirana shtrihet në koordinatat 41.33° veri dhe 19.82° lindje.

### Relievi

Qarku i Tiranës shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë në një lartësi që varion nga disa metra mbi nivelin e detit deri në 1828 m, që përfaqësohet nga maja më e lartë e Malit me Gropa. Qarku ka një territor prej 1652 km<sup>2</sup> dhe renditet i dhjeti, për sa i takon madhësinë e sipërfaqes në listën e 12 qarqeve të Shqipërisë.



Qarku i Tiranës, në pjesën e tij perëndimore, ka një vijë bregdetare me detin Adriatik, me gjatësi 33 km, ndërsa në veri kufizohet me Qarkun e Durrësit, në verilindje me Dibren, në juglindje me Elbasanin dhe në jug me qarkun e Fierit.

Relievi i Qarkut të Tiranës është një kombinim i larmishëm i zonës malore me zonat e uletave fushore dhe zonat bregdetare. Duke ju referuar shtrirjes gjeografike, zona malore e Tiranës është e vendosur kryesisht në verilindje, në kufi me Qarkun e Dibres dhe në pjesën juglindore, që kufizohet me Qarkun e Elbasanit. Në këtë pjesë gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit. Ky park është i vendosur në lindje të kryeqytetit, në distancën 23 km larg dhe zë një sipërfaqe rreth 3300 hektarësh. Maja më e lartë e Dajtit arrin në lartësi 1612 m mbi nivelin e detit. Në Parkun Kombëtar të Dajtit, në shpatin perëndimor të malit, gjendet pjesa e quajtur Ballokoni i Tiranës që shtrihet në lartësi 1000 m mbi nivelin e detit dhe është e gjatë 2 km. Po në lartësi 1000 m mbi nivelin e detit gjendet edhe rrafshina e Bizes e cila është pjesë e Malit me Gropa. Në këtë zonë gjenden formacione /gropa karstike që krijojnë peisazhe të mrekullueshme. Në pjesën e parkut kombëtar shtrihet edhe Mali i Priskës (1353 m) që së bashku me Malin e Dajtit mbulojnë një zonë prej 29216 hektarësh. Në zonën malore të qarkut të Tiranës gjenden edhe qafa e Priskës me lartësi 850 m dhe qafa e Kerrabes me lartësi 933 m mbi nivelin e detit. Zona fushore e qarkut të Tiranës shtrihet në pjesën jugore dhe jug-perëndimore të tij, në kufi me Qarkun e Fierit dhe atë të Durrësit. Kjo zonë ndodhet kryesisht në territorin e bashkive të Vores, Kavajës, rrogzhinës si dhe në komunat që janë vendosur rreth këtyre bashkive.

## Karakteristikat Klimatike

**Temperatura e ajrit** - Persa i perket luhatjes brenda vitit te temperatures se ajrit duhet thene se kemi te bejme me nje regjim tipik ku temperatura minimale vrojtohet ne muajin Janar, 6.9°C, ndersa temperatura maksimale vrojtohet ne muajt Korrik dhe Gusht 23.8°C. Ne zonen tone, rendesi paraqesin gjithashtu edhe numri i diteve me temperature nen - 10°C, qe quhen dite te akullta. Ne zonen ne te cilen shtrihet objekti ne studim, temperaturat nen -10°C jane teper te rralla. Dite te ftohta ndodhin gjate periudhes se ftohte te vitit (Nentor-Mars) ku me te shquarit jane muajt Dhjetor dhe Janar, ndersa ditet me temperature nen -5°C jane shume te rralla dhe vetem nje dite eshte ne muajin Janar. Persa i perket temperaturave te ajrit duhet thene se zona ne studim karakterizohet nga nje klime e bute mesdhetare.

**Rreshjet atmosferike** - Faktoret qe ndikojne ne karakteristikat e reshjeve atmosferike jane ne pozicionin gjeografik, afersia me detin dhe orografia.

**Era** - Shpejtesia e eres ne territorin e zones ne studim ashtu si ne te gjithe vendin tone, eshte ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur vepriprimaria ciklonare eshte e theksuar. Ne kete stine shpejtesite mesatare luhaten rreth 1.6 m/s

**Stuhite** - Stuhite qe per vendin tone jane te shumta dhe ndodhin ne te gjithe stinet e vitit, shpesh shoqerohen me bresher. Me shume dite me bresher ka ne muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe ne gjysmen e pare te pranveres. Numri me i madh i diteve me bresher vrojtohet ne rrethin e Tiranes dhe Kamez. Tirana gjate viti ka 8 dite me bresheri. Si rregull, zgjatja e breshrit eshte 3 deri 5 minuta. Gjate muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht nje dite me bresheri, Ne periudhen e ngrohte te vitit numri i diteve me bresher eshte i pakët. Stuhite ne zonen ne studim mund te ndodhin ne çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar qe ka klima e zones tone. Ne thellesi te territorit te Gadishullit Ballkanik gjate periudhes se ftohte te vitit (dimrit) stuhite pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental te klimes me ate rajon.

## **Siguria rrugore**

Aksidentet rrugore janë problemi i dytë më i rëndë i shëndetit në Shqipëri dhe situata po përkeqësohet për shkak të rritjes së shpejtë të trafikut. Përlllogaritet që edhe nëse investohen shuma të mëdha parash në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, ky investim, edhe në rastin më të mirë, do të kontribuojë në zvogelimin e numrit të aksidenteve rrugore të rënda për shkak të rritjes së shpejtësisë duke qenë se rrugët janë përmirësuar, kombinuar kjo me një numër të madh drejtuesish automjetesh relativisht pa eksperiencë. Zyrtarisht, llogariten që jo të gjitha aksidentet me pasojë vdekjen raportohen, e megjithatë pranohet se numri i këtyre aksidenteve është nga më të lartat ndërmjet vendeve Europiane. Çështja e sigurisë rrugore dhe nevoja për mirëmbajtjen e duhur të rrugëve është një prioritet domethënës veçanërisht nën dritën e statistikave zyrtare, të cilat tregojnë se nivelet trafikut rrugor po rriten me mbi 10 % në vit.

## **Transporti**

### *Transporti Rrugor*

Tirana ndodhet rreth 40 km larg portit më të rëndësishëm të vendit, që ndodhet në Durrës. Qysh prej vitit 2000 dy qytetet lidhen me autostradë. Nga Tirana udhëtojnë përditë autobuzë për në qytetet më të rëndësishme të vendit

### *Transporti ajror*

Në Rinas gjendet Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", i cili është rreth 25 km larg nga Tirana. Linjat ajrore lidhin Tiranën direkt me metropolet e Evropës Perëndimore, Evropën Lindore dhe prej andej me mbarë botën.

*Trafiku rrugor* kontribuon në ndotjen e ajrit nëpërmjet: numrit të lartë të automjeteve në njësinë e kohës; vjetërsinë dhe gjendjen teknike të automjeteve si rezultat i të cilave nuk plotësohen normat e shkarkimit në ajër të tyre; cilësisë së lëndës djegëse; përdorimit të automjeteve me motor pa konvertor analitik; mungesave në sistemin e menaxhimit të trafikut; gjendjes së rrugëve veçanërisht në zonat me urbanizim të vonë dhe atyre ndërmjet blloqeve të banimit (si rezultat i amortizimit); mungesën e parkimeve që bëhet shkak për kohën e shtuar të qarkullimit që rezulton me shtimin e emetimeve të PM10 dhe NO2.

Ndër faktorët e kontribues në ndotjen e ajrit janë:

- ***Ndotja industriale*** dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta (urbane dhe inerte), kryesisht për shkak të mangësive në infrastrukturën e nevojshme, si dhe faktorët natyrorë.
- ***Pamjaftueshmëria e sipërfaqeve të gjelbërta*** ka ndikimin e saj në ndotjen e cilësisë së ajrit sidomos në përqëndrimin e pluhurit.

### **Zhurma**

Tirana është qyteti më i prekur nga ndotja akustike në Shqipëri për shkak të popullsisë së madhe por edhe trafikut.





## ***Gjendja ekzistuese dhe informacione te përgjithshme***

- **Gjendja ekzistuese e segmenteve rrugore ku do te kaloje korsia e dedikuar autobusave**

Krijimi i infrastrukturës për shtrirjen e korsive të dedikuara për shërbimin e transportit qytetës në disa rrugë kryesore të Qytetit, optimizimi i ndalesave të autobusëve urban dhe informatizimi i tyre, sikurse rikonstruksioni dhe rikualifikimi urban i kryqëzimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit të qytetit të Tiranës.

Projekt zbatimi i korsive të dedikuara për autobus në disa akse rrugore, përfshin rruget si me poshte:

- Unaza e mesme ( nga kryqëzimi i “Brrylit” deri te ura “Vasil Shanto” në të dyja anët e lumit “Lana”).
- E “Kavajës” (segmenti nga sheshi “Mustafa Qemal Ataturku” - kryqëzimi me “Ibrahim Rugova”)
- “Muhamet Gjollësia” (segmenti nga ura “Vasil Shanto” – sheshi “Karl Topia”)

Rehabilitimi i stacioneve përfshin 3 korridoret e linjave të transportit publik qytetës si dhe zonën përreth qendrës ku dhe përqëndrimi i udhëtarëve dhe kërkesa për transit është më e madhe:

- Linja “Kinostudio Kombinat”
- Linja “Tirana e Re”
- Linja “Unaza”

Gjate rikonjucionit nga studio jone projektuese gjëndja e infrastrukturës në rrugë paraqitet si më poshtë:

- **Kanalizimet e ujrave të zeza**

Është i pranishëm rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza.

- **Kanalizimet e ujrave të bardha**

Është i pranishëm rrjeti i kanalizimit të ujërave të bardha.

- **Rrjeti ujësjellësit**

Është i pranishëm rrjeti i ujësjellësit.

- **Rrjeti ndriçimit rrugor**

Është i pranishëm rrjeti i ndriçimit rrugor.

- **Gjelbërimi**

Rrugët në gjatësinë e tyre janë të gjelbëruara dhe me pemë.





Rruget janë kryesisht në gjendje të mirë. Ka demtime të riparueshme në pjesën e asfaltit në disa segmente ku aktualisht janë vendparkime për automjete. Sipas detyrës së projektimit rrjeti I kanalizimeve të ujërave dhe bardha dhe të zeza është funksional dhe në gjendje të mirë. Në stacionet e urbaneve mungojnë tabelat informuese për qytetaret. Në mungesë të një korse të dedikuar autobusave kemi vonesa në frekuencën e tyre, trafik, tejmbushje e tyre. Gjithashtu është I nevojshëm rehabilitim i kurorave të gjelbërta përgjatë segmenteve të projektit, vënd grumbullim të mbetjeve urbane dhe elementit ndarës/mbrojtës të kësaj korse të përshtatshme për evitimin e “kërcimit të gomave”.

*Ortofoto e segmenteve rrugore*



*Foto nga kryqezimi 21 dhjetori*



*Foto nga kryqezimi i Zogut te zi*






*Foto nga ura Vasil Shanto*



*Foto nga zona e Brrylit*

*Foto gjendja ekzistuese e rruges se Kavajes*



*Foto gjendja ekzistuese e rruges se Kavajes*




- **Gjendja ekzistuese e nyjes Kastriotet**

Nyja Kastriotet eshte nje pike teper problematike, krijimi i trafikut dhe ngegja e qarkullimit eshte nje fenomen i perditshem, zgjidhja e kesaj nyje eshte e domosdoshme.



Për sa i përket projektimit të rrethrotullimit do te merret parasysh që ai të:

- pakësojë “konfliktet” e rënda për këmbësorët dhe çiklistët;
- sigurojë më shumë kohë që drejtuesit e automjeteve që hyjnë në rrethqarkullim, të gjykojnë, të përshtasin shpejtësinë dhe shfrytëzojnë boshllëkun e krijuar për t’u bashkuar me trafikun që qarkullon në rrethrotullim;
- lejojë bashkimin e sigurt në trafikun që qarkullon në rrethqarkullim;
- sigurojë më shumë kohë për të gjithë përdoruesit të dallojnë dhe korrigjojnë gabimet e tyre apo gabimet e të tjerëve;
- të bëjë që pëplasjet të jenë më të rralla dhe më pak të rënda;
- t’i bëjë nyjat më të sigurta për përdoruesit e rinj.



Kjo nyje eshte pike e perbashket e 3 rrugëve, Rruga Kastriotet, Unaza e madhe dhe Rruga Ali Ibra. Rruga Kastrioti eshte pjese e rruges E762, pjesë rrugore e rrjetit ndërkombëtar të rrugëve elektronike.

*Foto te gjendjes egzistuese nyja Kastriotet*





*Foto te gjendjes egzistuese nyja Kastriotet*




## ZGJIDHJA TEKNIKE OBJEKTI:

### **“NDERTIMI I KORSIVE TË DEDIKUARA PËR AUTOBUS NË DISA AKSE RRUGORE, ZGJIDHJA E NYJES KASTRIOTET DHE REHABILITIMI I STACIONEVE AUTOBUS NË ZONEN QËNDRORE TË TIRANËS”**

- ***Ndertimi i korsive të dedikuara për autobus në disa akse rrugore***

Ndërtimi i korsive të dedikuara për autobus në disa akse rrugore dhe rehabilitimi i stacioneve autobus në zonën qendrore të Tiranës përfshin krijimin e korsive të rezervuara të transportit urban për autobusë në qytetin e Tiranës në segmentin e rrugës “Muhamet Gjollesha”; përgjatë “Lanës”, segmenti nga Brryli – ura Vasil Shanto; Kavajës nga ish 21 Dhjetori deri në Qendër. Vonesa e autobusëve, tejbushja e tyre, mungesa e sinjalistikës dhe korsive dedikuar transportit urban janë disa prej problematikave të përdorueseve të transportit urban . Nisur nga këto problematika propozojme ndryshimin e korsive të vendpikimit në korsi të dedikuar transportit urban. Stacionet e ndalimit dhe itinerari do mbeten të njëjta.



*Segmenti i rruges rrethrotullimi Zogu i Zi – 21 Dhjetori*


Ne kete segment rrugor nuk ka egzistuar nje korsi e dedikuar transportit urban. Projekti propozon te mos nderhyhet ne trupin e rrugen dhe rrjetin infrastrukturor dhe te behet ndryshimi I vendparikimeve per automjete ne njerin krah te rruges ne korsi te dedikuar per autobuze duke shmangur keshtu trafikun , vonesa ne frekuencen e autobuzave , mbingarkese te tyre. Stacionet e autobuzave do mbeten te njetat ne te dyja drejtimet e levizjes dhe pajisja me te gjitha tabelat e nevojshme informuese, lajmeruese , urdheruese etj. Gjeresia e korsise se dedikuar transportit publik parashikohet te jete 2.8 m dhe gjeresia e separatoreve 0.5m Rruga perbehet nga dy karrexhata me te njejta parametra Parametrat e karrexhates rrethrotullimi Zogu I zi – Kryqezimi 21 Dhjetori jane:

- Korsi kalimi per automjete 2x 2.8 m
- Kunete 0.5 m
- Bordure 0.15 m
- Brez I gjelbert 1.8 m
- Trotuare me pllaka 5.3 m

Parametrat e rruges me dy karrexhata Kryqezimi 21 Dhjetori – Vasil Shanto jane:

- Korsi kalimi per automjete 2x 3 m
- Kunete 0.5 m
- Bordure 0.15 m
- Brez I gjelbert 1.5 m
- Trotuare me pllaka 6.7 m

Gjeresia e korsise se autobuzit parashikohet te jete 2.9m dhe gjeresia e separatoreve 0.5m



*Segmenti kryqezimi 21 Dhjetori – "Vasil Shanto"*


Gjithashtu parashikohet riparimi I nje segmenti ne te cilin kemi demtim te asfaltit me nje siperfaqe totale prej 660 m<sup>2</sup>

### **Segmenti i rruges Vasil Shanto- kryqezimi i Brrylit**

Ky segment nuk eshte i pajisur me korsi te dedikuar per transport publik ne te gjithe gjatesine e tij. Zbatimi i korsive të autobusëve dhe pajisja e tyre me sinjalistikë ndriçuese është një mënyrë me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin për të përmirësuar transportin publik duke ulur njëkohësisht bllokimin e trafikut. Nuk do te nderhyhet ne trupin e rruges dhe ne rrjetet infrastrukturore .Stacionet e autobuzave do mbeten te njetat ne te dyja drejtimet e levizjes dhe pajisja me te gjithe tabelat e nevojshme informuese, lajmeruese , urdheruese etj. Gjeresia e korsise se dedikuar transportit publik parashikohet te jete 2.9 m dhe gjeresia e separatoreve 0.5 m

Parametrat e rruges me dy karrexhata rrethrotullimi *Vasil Shanto- kryqezimi i Brrylit jane:*


- Korsi kalimi per automjete 2 x 3.6 m
- Kunete 0.5 m
- Bordure 0.15 m
- Brez I gjelbert 1.8 m
- Trotuare me pllaka 4.2 m



*Segmenti i rruges Vasil Shanto- kryqezimi i Brrylit*

### Segmenti fillim Rruga e Kavajes – kryqezimi 21 Dhjetori- Qender

Gjiashtu ky segment nuk eshte i pajisur me nje korsi autobusash duke krijuar vonesa te njepasnjeshme , mbingarkese ne transportin publik. Kordia fillon rreth 170 m nga kryqezimi i 21 Dhjetorit deri ne Qender. Nuk do te nderhyhet ne trupin e rruges dhe ne rrjetet infrastrukturore .Stacionet e autobusave do mbeten te njetat ne te dyja drejtimet e levizjes dhe pajisja me te gjithe tabelat e nevojshme informuese, lajmeruese , urdheruese etj. Gjeresia e korsise se dedikuar transportit publik parashikohet te jete 3 m dhe gjeresia e separatoreve 0.5 m



*Segmenti i rruges 21 Dhjetori - Qender*

- Vendosije te tabelave te informacionit ne stacionet e autobuzave.




Tabela do të japë informacion për shërbimin dhe përshkrimin e itinerareve individuale në çdo ndalesë. Duke filluar nga e majta lartë në të djathtë poshtë, ai do të përfshijë elementët e mëposhtëm.

- Vendndodhja ose emri i zonës (nëse është pjesë e panelit me shumë itinerare),
- Numri i itinerarit,
- Diagrami horizontal linear i itinerarit ku renditen ndalesat dhe mundësisht "vendndodhja aktuale",

14

Lulishte 1 Maji



drejt Drejtorise se Policise  
Ish-Kinema Agimi

1A/B

14

16<sup>B</sup>



FREKUENCAT SHTATOR - QERSHOR

Nga e hëna në të premte	
05:30 - 06:10	çdo 10 min
06:10 - 20:10	çdo 6-8 min
20:10 - 21:30	çdo 10 min
21:30 - 22:30	çdo 15 min
22:30 - 23:30	çdo 20 min
E shtunë, e diel dhe festa zyrtare	
05:30 - 23:30	çdo 10 min

FREKUENCAT KORRIK - GUSHT

Nga e hëna në të premte	
05:30 - 21:15	çdo 7 min
21:15 - 23:25	çdo 10 min
E shtunë	
05:30 - 17:30	çdo 8 min
17:30 - 23:30	çdo 10 min
E diel dhe festa zyrtare	
05:30 - 18:20	çdo 10 min
18:20 - 23:20	çdo 15 min



www.tirana.al



- Autobusët e parë dhe të fundit, (dhe mundësisht shpeshtësia sipas periudhave të ditës dhe) ditët e javës; e hënë-e premte, e shtunë-e diel dhe festat kombëtare,
- Të dhënat e kontaktit,
- Kodi specifik i vëndndodhjes së zonës,

Të merren parasysh mundësitë e vendosjes së shënjesve me prekje për të ndihmuar pasagjerët e verbër.

**Detajet teknike – përmasat e shtyllës së informacionit.**


- Lartësia: Lartësia optimale e shtylles 3500 mm duke mundësuar një lartësi të përshtatshme me qëllim që tabelat të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të identifikueshme nga një distancë e largët.
- Gjerësia: Gjerësia optimale e e tabelës së sipërme 450 mm, në formatin "portret".
- Gjerësia: Gjerësia optimale e e tabelës së poshme 240 mm.
- Bazamenti : Thellësia e bazamentit të jetë 650 mm me lidhje me prixhionere 550 mm,

**Elementët që duhet të kenë shtylla:**

- Identifikuesi (i njohur gjithashtu si "flamuri"),
- Drejtimi i udhëtimit (zakonisht i njohur si parimi i njoftimit "drejt" lagjes, pikës së shkëmbimit ose destinacionit të radhës),
- Numrat e itinerarit (tregohen në mënyrë numerike dhe alfanumerike) horizontalisht nga e majta lartë në të djathtë poshtë (lartësia e gërmave/numrave  $35 \pm 5$  mm),

- d) Mesazhe të veçanta shtesë,
- e) Kodi unik i identifikimit (veçanërisht i dobishëm për menaxhimin e objekteve dhe shërbimet publike opsionale me bazë teksti),- stacioneve të autobusëve duhet t'u jepet një kod unik,
- f) Pika tipografike (identifikimi alfa dhe alfanumerik i vendndodhjes specifike në pikat më të mëdha të shkëmbimit të linjave).


Shtylla do të përmbajë dhe një element në pjesën e poshtme me informacion mbi linjat dhe itineraret .




Punime te tjera qe jane propozuar te projektit:


- Krasitje e kurores se gjelbet per gjithe segmentin. Krahas punimeve te infrastruktures dhe sinjalistikes rendesi ka dhe mirembajtja e mbuleses bimore ku pershihen krasitje e pemeve dhe e shkurreve dekorative ,kositje e mbledhje mбетjesh .





- Riparim te asfaltit ne korsite e demtuara. Nga zona e kryqezimit te Inxhinierise deri ne kryqezimin e 21 Dhjetorit pjesa e korsise egzistuse te autobuzave eshte e demtuar dhe duhet skarifikuar asfalti i demtuar dhe riasfaltimi i tij.





- Shtrese llambadaresh autobuzi ne semafore.

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale, horizontale si dhe atë semaforike. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Pranë kryqëzimeve do të vendosen shtylla njoftuese për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës.

Ne mungese te korsise se autobuzave nuk jane vendosur me pare shtrese llambadaresh autobuzi ne semafor e cila ka ndikur dhe ne kushtet e qarkullimit dhe sigurise rrugore. Propozojme ato te shtohen ne cdo pike qe ka semafore ne menyre qe qarkullimi i automjeteve dhe kembesoreve te jete me i sigurte.



- Krijimi i nje vendeve te reja per grumbullimin e mbeturinave . Ne disa segmente te rruges mungojne vendgrumbullime per mbeturina.

Fillimisht do te behet skarifikimi i pjeses se trotuarit ku do te vendosen koshat ne menyre qe te vije ne nje nivel me rrugen dhe te te vendosen tre kosha per grumbullimin e mbeturinave.


## Krijimi i nje vendi te ri per grumbullimin e mbeturinave




- Spostim i stacionit te autobuzit. Stacioni i vjeter eshte afer ktheses ndaj propozojme qe te zhvendoset si ne figure dhe prishje e bordurave te rruges .Ne disa segmente bordurat e betonit duhet te prishen me qellim qe te mos pengojne kalimin e korsise se re te autobuzit.Stacionet e spostuara jane "**Zogu i Zi**" UID 1200 dhe Stacioni "**Poliklinika Nr. 9**" UID 1077. Gjitashtu te behet vendosja e separetoveve pergjate korsise se autobusave per parandalimin e kalimit te automjeteve te tjera ne kete kors.



1) Pozicioni ekzistues





2) Pozicioni I ri




- Ne disa segmente te rruges jane shtuar vende parkimi per mjete mallrash

Shtim 3 vende  
parkimi per  
mjete mallrash






Detaj Rruga “Muhamet Gjollësia”



Detaj Stacioni ne “Vasil Shanto”



- ***Nyja Kastriotet***

Nyja Kastriotet e pozicionuar ne Bashkine Kamez, eshte nje pike teper problematike, krijimi i trafikut dhe ngecja e qarkullimit eshte nje fenomen i perditshem.

Zgjidhja e kesaj nyje eshte e realisht nje domosdoshmeri dhe kerkon nje realizim ne nje kohe te shpejte.



Rrethrotullimi është pjesë e planifikimit me të lehtë si dhe mundëson qasje më të sigurve të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion. Projektimi dhe ndërtimi i rrethrotullimeve realizohet në udhëkryqet që trafiku është më i paralizuar dhe me ndërtimin e tyre krijohen lehtësira dhe situata të favorshme për ta tejkaluar avarinë në trafik si dhe duke i larguar pikat e rrezikut. Prioriteti bazë tek rrethrotullimet janë rrugët kryesore hyrëse që sigurojnë kalimin e automjeteve pa pengesa të mëdha duke i renditur nga prioriteti, domethënë të rregulluara me përparësi kalimi të rregulluara me shenja trafiku. Pika e parë e realizimit është shfrytëzimi i sipërfaqes nga sinjalizimi vertikal që tregon hyrjen në rrethrotullim, ndërsa në dalje përfundon me shenjat për lëvizje përkatëse duke shfuqizuar shpejtësitë e kufizuara. Çdo gjë është mjaftë e kufizuar dhe varet nga gjatësia, numri i

pikë takimeve gërshetimeve lloji i automjetit qarkullimi dhe praktika dhe sjellja e ngasëseve. Raporti mes udhëkryqeve dhe rrethrotullimeve është i ngushtë por krijohen edhe manovrime shitesë si mbushjet, zbrazjet gërshetime , ndërimi i shiritave kërkojnë realizim dhe kushte të posaçme të trasesë me elemente të saj, prerje tërthore, gjatësore, dukshmëri të nevojshme, kushte specifike të ndërtimit dhe qarkullimit nëpër sipërfaqen e rrethrotullimit të projektuar.

Për sa i përket projektimit të rrethrotullimit do te merret parasysh që ai të:

- pakësojë “konfliktet” e rënda për këmbësorët dhe çiklistët;
- sigurojë më shumë kohë që drejtuesit e automjeteve që hyjnë në rrethqarkullim, të gjejnë, të përshtasin shpejtësinë dhe shfrytëzojnë boshllëkun e krijuar për t’u bashkuar me trafikun që qarkullon në rrethrotullim;
- lejojë bashkimin e sigurt në trafikun që qarkullon në rrethqarkullim;
- sigurojë më shumë kohë për të gjithë përdoruesit të dallojnë dhe korrigjojnë gabimet e tyre apo gabimet e të tjerëve;
- të bëjë që pëplasjet të jenë më të rralla dhe më pak të rënda;
- t’i bëjë nyjat më të sigurta për përdoruesit e rinj.

Kjo nyje eshte pike e perbashket e disa rrugëve, Rruga Kastriotet, Rruga Elez Isufi, Unaza e madhe dhe Rruga Ali Ibra. Rruga Kastrioti eshte pjese e rruges E762, pjesë rrugore e rrjetit ndërkombëtar të rrugëve elektronike.

Pergjithsisht, dimensionet e rrethrotullimeve duhet të garantojnë këto veçori:


- Rrezen e mjaftueshme për të zvogëluar shpejtësinë e automjeteve në jo më shumë se 59 km/h ➤
- Automjetet në hyrje duhet të devijojnë pak nga drejtimi i tyre dhe të zhvillojnë shpejtësi të vogla
- Automjetet e mëdha duhet të përshtatën duke i përdorur hapësirat e përparme dhe hapësirat tjera të rrethrotullimeve

Perpara nisjes se projektimit, paraprakisht nisi puna ne terren. Nje grup i perbere nga inxhinier dhe topograf te zyres shkuan dhe realizuan proceset si me poshte:


- U be azhornimi (rilevimi) i nyjes. Ku jepet plani i plote i piketimit, (me pikat e forta);
- U mor ne konsiderate dhe u procedua nga inxhinieret perkates studimi gjeologjik, hidrologjik (sipas kerkesave te projektimit) i zones



**Prerje A-A e rrethrotullimit**




**PLANI TEKNIK**  
SHKALLA 1:100



*Pamje 3 Dimensionale*






## Sinjalistika

Sinjalistika përfshin sinjalistikën vertikale, horizontale si dhe atë semaforike. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Pranë kryqëzimeve do të vendosen shtylla njoftuese për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës. Do të merren parasysh të gjitha elementet e sigurisë rrugore ku sinjalistika është vetëm një komponent i saj. Do të merren në konsideratë problemet e mundshme të sigurisë në lidhje me përdoruesit e rrugës sipas kategorive ku hyjnë në mënyrë të përgjithshme elementët për mjetet (dukshmëria, hyrje dalje dhe tipi i saj, parakalimi, gjërësia e korsive për qarkullim të përzier të mjeteve, pikave të konfliktit në një kryqëzim etj) e deri te këmbësorët në mjaftueshmërinë e pikave të kalimit të këmbësorëve dhe krijimin e rampave. Hartimi i projekteve për zbatim të sinjalizimit rrugor sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit.

Ne projekt është trajtuar mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësorëve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat.

### *Planimetria e sinjalistikës*



### **Specifikime për materialet:**

- a) Materialet e ndryshme strukturore, ato do të jenë rezistente ndaj elementeve atmosferik si edhe ndaj elementeve me permbajtje gerryese.
- b) Të gjitha rafiniturat e bojës do të jenë të mbrojtur nga rrezet ultravjollcë (UV), me gjysmë shkëlqim, me një jetëgjatësi mbi 7-vjeçare.
- c) Të gjitha pajisjet fiksuese të jashtme dhe të dukshme do të jenë rezistente ndaj ngacmimeve dhe të mbrojtura kundër korrozionit.
- d) Bojërat e printimit duhet të kenë ngjyra rezistente, që nuk zbehen dhe të jenë të mbrojtura nga rrezet ultravjollcë për një periudhë minimale prej 7 vitesh, ose sipas jetëgjatësisë së materialit që do të printohet p.sh. uPVC vetëngjithëse dhe/ose polikarbonat.
- e) Filmat vetëngjithës të kenë një tkurrje minimale pas ekspozimit të zgjatur nën rrezet e diellit dhe nxehtësi.

### **3. Standarte në projektim dhe në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi do të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi jone si projektues saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Ne si projektues do të rekomandojmë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet do të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

# Studimi i Mobilitetit “Rrethrotulimi Paskuqan”

## I. Situata ekzistuese (infrastruktura, transport publik, levizja e kembesoreve dhe bicikletave)

### 1. Hyrje

Zona ku do kryhet studimi ndodhet në zonen veriore të qytetit në rrugë Kastriotet në degezin me rrugën e Paskuqanit.



Fig:1 Zona ne studim


### 2. Baza Ligjore

Ligj Nr. 8378, date 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), Vendimi nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së shqipërisë” (i ndryshuar). Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015 Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

### 3. Popullsia ne zone

Bazuar në raportimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, popullsia e Tiranës në vitin 2021 rezulton 863 694 banorë duke pësuar një rritje me 1.5%, krahasuar me vitin 2020 ose 13,164 banorë, ku gjatë vitit 2021, shtesa natyrore e popullsisë është 1,184 banorë (Lindje-Vdekje), duke pësuar një rënie prej 6.3%, krahasuar me një vit më pare. Dendësia e popullsisë së Tiranës u rrit me rreth 8 banorë për km<sup>2</sup> duke arritur në 777 banorë/km<sup>2</sup>

Për sa i përket popullsisë e llogaritur deri në 2030 është:



Numri i njësive tregtare janë 5 subjekte ku përfshihen: Qendra Tregtare , Terminali ( parashikim) lokale, njësi shërbimi.

#### 4. Infrastruktura rrugore

- Rruga urbane kryesore
- Rruga Paskuqanit urbane kryesore
- Rruga Ali Ibra Rruga lokale




Fig:2 Rrjeti rrugor sipas PPV2017(ndryshuar)

## 5. Kembesor dhe bicikleta

Mungojne korsit e bicikletave ne zone dhe lidhja me qytetin

## 6. Shërbimi urban

Zonen e pershkruajne:

**Linjat Urbane Qytetese** Institut – Qnende dhe Linja Kamez

**Linjat Urbane Rreth Qytetese** ska

**Terminali i Udhetareve Jug Veri** ku kalojne linjat e Veriut

**Terminali i Udhetareve Jug Lindje** ( Nderkombetare) me linjat Kosove

# II. Volumet e trafikut sot ne akset kryesore

## 1. Realizimi i Matjeve te trafikut

Nga monitorimi dhe përlogaritjeve e bera në orët e pikut janë:

- Rruga Kastriotet VJ 1100-1200 mjete/orë
- Rruga Kastriotet VL 300-400 mjete/orë
- Rruga Kastriotet VJ dajle 1250-1300 mjete/orë
- Rruga Kastriotet 350-400 mjete/orë
- Rruga paskuqan 400-450 mjete/orë
- Rruga Ali Ibra 400 mjete/orë





Fig:3 Flukset e trafikut 2022

### III. Planet e zhvillimit te zones lidhur me infrastrukturen.

Akse kryesore qe lidhen me zone jane:

- Unaza e madhe e Qytetit Tirane



Fig:4 Rrjeti rrugor sipas PPV2017(ndryshuar)

### IV. Planet e zhvillimit te zones lidhur me transportin publik.

Terminali i RI Udhetareve Jug Veri me linjat nga Veriu

Terminali i Udhetareve ( Nderkombetare)

Pritet te gjeneroje se bashku me linjat qytetese dhe linjat rreth qytetese te zones Veriore.

### V. Zgjedhja e alternativave më të mira.




Fig 5. Grafiku ne baza te volumeve te trafikut 2023




Fig 6 varianti 2 zgjidhja me rreth

### Varianti 1

Zgjidhja e nyjes me semafor

### Varianti 2

Zgjidhja e nyjes me rrethrotullim

### Argumentat (Pro) dhe Kunder (jo)

	Fushëpamja	Aksesi	Siguria	Programet inxhinierike
Varianti 1	pro	jo	pro	jo
Varianti 2	pro	pro	pro	pro

## VI. Mikro simulime (Vissim) te alternativave më të mira.

Mikrosimulime trafiku per perballimin e kerkeses per levizje ne nyjet qe do kete rruga, si dhe vleresimi i alternativave me te mire per gjetjen e zgjidhjes (vonesat, masa e ngarkeses, vargu etj)

## VII. Programet e perdorura



Fig:7 Programi I perdorur Autoturn Pro 10



Fig:8 Programi I perdorur Torus

## VIII. Zhvillimi i alternativës më të mirë si dizajn në formatin dwg




Fig:9 alternativa me e mire

## IX. Raporti përfundimtar

Në bazë të rezultateve të arritura, sugjerojmë Variantin 2, domethënë: ndërtimi e rrethrotullimit.

Për më tepër, nga pikëpamja funksionale rrotullimi mundëson zvogëlimin e numrit të pikave konfliktuale dhe shpejtësisë ndërsa garanton njëtrajtshmërinë e lëvizjes midis automjeteve që afrohen dhe kalojnë në rrethrotullim, duke eliminuar manovrat e kthesave të majta në formë U-je që janë shkaku kryesor i aksidenteve rrugore.

Më konkretisht, verifikimet e kryera kanë treguar se në nivel makroskopik, rrotullimi do të garantojë një nivel të mirë shërbimi. Sipas llogarive të përcaktuara në studimet referuese,

qarkullimet e trafikut të menaxhuara nga terminali priten të arrijnë më shumë se dyfishi. Këto volume trafiku do të krijojnë probleme serioze për rrotullimin.

Duke marrë në konsideratë dhe shtimin e fluksit të mjeteve mbas realizimit të Unazës të Tiranës, rritjen e popullsisë në zonën përreth, propozojmë zgjidhjen e njëjës me rrethrotullim.

## **INFRASTRUKTURA SPECIFIKIMI I SHQYRTIMIT TË PUBLICITETIT - POSTIMI**

Përshkrimet e performancës (duke plotësuar specifikimet e përbashkëta më parë për ndërtimin e tij, duke përfshirë minimumin e mbrojtjes nga depërtimi (IP) dhe mbrojtjen nga ndikimi (XP)) ;

Ndërsa vlera IP duhet të parandalojë depërtimin e ujit, kondensimi atmosferik duhet të menaxhohet për të zgjatur integritetin e medias së shfaqur. Një i tillë ky ujë i cili mbledhet si pika në një sipërfaqe të ftohtë kur ajri i lagësht është në kontakt me të duhet të jetë në gjendje të kullojë duke kërkuar një minus disa vrima kullimi në pjesën më të poshtme të pikës së prodhimit, nominalisht 7+-1mm diametër me hapje të ngjashme të barabarta të ajrosjes në pikën më të sipërme të fabrikimit duke lejuar që pjesa e brendshme të ajroses në mënyrë natyrale. Nga ana tjetër, media duhet të mbahet dhe të shfaqet në sipërfaqen e brendshme të pasme të xhamit për të zvogëluar mundësinë që kondensimi të errësojë median duke lejuar që lagështia dhe ajri të qarkullojnë pas medias. Mediat duhet të mbahen duke përdorur fiksime mekanike si kapëse çeliku të pandryshkshëm, shirita magnetike ose guarnicione gome EPDM të rregulluara në mënyrë që të mbeten të padukshme për lexuesin të fshehura jashtë syve.

Nxjerrja e xhamave të gomës/ekranit futet brenda dy pjesëve vertikale të kornizës së derës së ekranit të orarit.

Nxjerrja e ekranit mund të mbajë çdo kombinim të rrëshqitjeve të kapsuluara A5, mediave me madhësi A4 dhe AA4 ose AAA4.

Korniza e ekranit është e siguar duke përdorur një prizë sigurie fikse HEX të rezistuar ndaj ngacmimeve, ose ekuivalente të ngjashme dhe të miratuara për të reduktuar ngacmimet dhe vjedhjet.

Materiali informativ duhet të jetë i veshur nga lart majtas poshtë djathtas, i shfaqur në një rend numerik dhe alfanumerik, me çdo hapësirë(a) të mbetur të mbushur me material marketingu të fushatës.

"Poshtë" materialin e shfaqur kundër sipërfaqes së xhamit, siç tregohet, duke e rrëshqitur nën të dy skajet e kthyer të nxjerrjes. Përndryshe, ngrini një nga ekstrudimet dhe shtyjeni fort materialin e ekranit nën të.

Më pas ngrini ekstrusionin e kundërt, duke 'përthyer' materialin e ekranit dhe duke e rrëshqitur nën nxjerrje, duke e ushqyer me gishta.

